



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 2845/prot.
13

Elbasan, më 20 / 12 / 2021

VENDIM

Nr. 37 datë 17.12.2021

"PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË
"DOKTORATË NË SHKENCAT EKONOMIKE" NË FAKULTETIN EKONOMIK"**

Bazuar në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2/b; neni 35 pika 1/dh; neni 37 dhe neni 91, pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL" i ndryshuar; në Udhëzimin të MASR-së nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësiive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë" Kreu IV, germa "E"; në Statutin e UE, me propozim të Fakultetit Ekonomik, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin paraprak të dokumentacionit për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve "*Doktoratë në shkencat ekonomike*" në Fakultetin Ekonomik.
2. Ky vendim t'i dërgohet për procedurë të mëtejshme Bordit të Administrimit të UE.
3. Ky Vendim, pas miratimit edhe nga Bordi i Administrimit, brenda datës së afatit të përcaktuar në platformën e-Albania, të ngarkohet nga përgjegjësit e njësisë bazë që kanë propozuar hapjen e programit të studimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI"
ELBASAN
K R Y E T A R I
Prof. Dr. **Skender TOPI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI EKONOMIK

PROJEKTI

RITJIA E KAPACITETEVE KËRKIMORE SHKENCORE
DHE PROFESIONALE TË FUSHËS SË EKONOMISË

Dhjetor 2021



PASQYRA PËRMBLEDHËSE E PRODUKTTIT TË PROJEKTTIT

Fusha kryesore e kërkimit : Shkencat ekonomike

Emërtimi i programit të Doktoratë në “Shkencat ekonomike”
studimeve të doktoratës

Cikli i studimeve:

Cikli i tretë

Lloji i programit:

Doktoratë

Njësia bazë

Departamenti Administrim Biznes,
Departamenti Financë Kontabilitet
Departamenti Ekonomiks
Departamenti Marketing Inxhinieri,
Departamenti i së Drejtës
Qendra Këkimore Shkencore për Kërkime dhe Zhvillime në Drejtësi dhe
Ekonomi
Fakulteti Ekonomik

Njësia kryesore

Studimi me kohë normale,
shprehur në vite:

3

Studimi kohë të zgjatur,
shprehur në vite:

5

Gjuha e studimit:

Shqip

Të dhënat për

Prof.as.Dr. Imelda Sejdimi

Koordinatorin e

Pozicioni në IAL: Dekan i Fakulteti Ekonomik

Doktoratës:

E-mail: imelda.sejdimi@uniel.edu.al



shkencore. Këto studime do të ndihmojnë në zhvillimin e të menduarit analitik, gjykimin dhe analizën e thelluar të fenomeneve, që janë objekt studimi i kërkimit shkencor në Shkencat Ekonomike.

Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore dhe profesionale të fushës së ekonomisë, konsiston gjithashtu në promovimin e një mjedisi që rrit potencialin e individëve, organizatave dhe komuniteteve për të marrë njohuri më të thelluara dhe për t'u aftësuar në këtë fushë. Kjo do t'i shërbejë më mirë përfitatjes me ndryshimet në funksion të përmblotjes së nevojave aktuale dhe nevojave të ardhshme. Rritja e kapaciteteve kërkimore shihet si formë e avancuar e rritjes së cilësisë prandaj paraget një çështje me rëndësi maksimale për shkencat ekonomike.

PËRMBLEDHJA E PROJEKTIT

Projekti “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore dhe profesionale të fushës së ekonomisë”, ka si mision formimin e një gjenerate të kualifikuar të profesionistëve të fushës së ekonomisë, në përputhje me Ojetivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, nëpërmjet realizimit të kërkimit shkencor efektiv e zhvillimor. Në bazë të projektit, qëndron rëndësia e arsimit, si përcaktues i rëndësishëm shoqëror. Formimi, arsimimi e shprehitë profesionale si dhe arsimimi universitar kërkimor shkencor, shërbejnë si nxitës për të hyrë në tregun e punës, për të dalë nga varfëria dhe për të rritur përfshirjen sociale. Mbi këtë arsyetim, implementimi i projektit orientohet drejt krijimit të Programit të Doktoratës në “Shkencat ekonomike”. Nëpërmjet zbatimit të këtij programi, do të nxitet veprimtaria kërkimore shkencore dhe e zhvillimit, duke e fuqizuar rolin e Universitetit të Elbasanit si një lider rajonal në kërkimin shkencor në fushën e ekonomisë, duke promovuar bashkëpunimin e ndërsjellë midis kërkuesve, për të ushtruar në vijim dejtrai si akademikë, kërkues dhe profesionistë të fushës me standardet më të larta bashkëkohore.

Projekti, nëpërmjet implementimit të kërkimeve individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia kryesore, kërkon t'i jepen zgjidhje sfidave aktuale dhe të ardhshme, duke trajtuar tematika që lidhen me manaxhimin, financën, kontabilitetin, marketingun, sipërmarrjen dhe biznesin ndërkombëtar në kushtet e globalizimit, tregjet, tregtinë, produktet, shërbimet dhe inovacionin, administrimin publik, politikat makroekonomike dhe mikroekonomike, etj.. Për këtë arsye, është menduar që projekti të hartohet për një periudhë pesëvjeçare me një kohëzgjatje të studimeve jo më pak se tre vite akademike dhe jo më shumë se pesë vite akademike, nga momenti i miratimit të tij në organet kolegjiale të institucionit të arsimit të lartë.

Objektivat e projektit mund të përmblihen si në vijim:

Objektivi i përgjithshëm i projektit për propozimin e programit të Doktoratës në “Shkencat ekonomike” në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit është përgatitja e studentëve nëpërmjet paisjes me njohuri të thelluara në shkencat ekonomike, për një karrierë të suksesshme në kërkim, në mësimdhënie si dhe në profesionet jo akademike.

Ky program synon të ofrojë për herë të parë studime të thelluara të ciklit të tretë në shkencat ekonomike, referuar nevojave dhe domosdoshmërisë së studimit dhe shkencat ekonomike në Dardun e Elbasanit e më gjerë, me synimin për të përmushur disa objektiva të rëndësishme të këtij



shkencor. Veprimtaria e Universitetit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në Ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UE-së si dhe në rregulloret që miratohen në zbatim të tij.

Në mënyrë të detajuar në UE funksionojnë:

I. Fakulteti i Shkencave Humane, me programe studimi Bachelor, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoratë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe dhe të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht), histori, gjeografi, gazetari, albanologji, programe profesionale dyvjeçare në sekretar i specializuar dhe operator turistik në gjuhën gjermane.

II. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me programe studimi Bachelor. Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, botanikë, zoologji, mbrojtje mjedisi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, gjeometri, fizikë teorike e eksperimentale si dhe programe profesionale dyvjeçare në teknik laborator, teknik mjedisi, mekatronikë, logjistikë .

III. Fakulteti i Shkencave të Edukimit, me programe studimi Bachelor. Master profesional në fushat e kërkimit të tij: mësimi për ciklin fillor (Klasës I-IV të shkollës 9-vjeçare), edukatorë për arsimin parashkollor, psikologji, filozofi, sociologji, edukim fizik dhe artistik si dhe program profesional dyvjeçar në edukator për moshat 0-3 vjeç.

IV. Fakulteti Ekonomik, me programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: administrim biznes (në specialitetet manaxhim dhe marketing), financë, kontabilitet, ekonomia dhe e drejta, shkencë juridike në biznes, shkencë juridike në sektorin publik, ekonomi turizëm, administrim biznes dhe inxhinieri dhe informatikë ekonomike, si dhe programin e integruar të ciklit ët dytë Msc. në Drejtësi.

V. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, programe studimi Bachelor, Master profesional dhe Master i shkencave në fushat e kërkimit të tij: infermieri, infermieri mami, teknik laborator, imazheri, manaxhim infermieror, fizioterapi dhe logopedi.

Që nga themelimi i UE-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore. Si kërkesa të natyrshme të rikuturimit të UE-së dhe si ndihmëse në procesin e mësimdhënies, janë ngritur e janë vënë në dispozicion laboratorë teknikë pranë secilës njësi kryesore.

Bashkërendimi i orëve teorike në të gjitha programet e studimit me orët e praktikës në laboratorë apo pranë institucioneve bashkëpunëtoare të UE-së, ka krijuar një rridimensionim të hapësirës së studentit. Politikat institucionale me në qendër studentin, kanë krijuar hapësira të pafundme për ndërkombëtarizimin e UE-së, duke u ofruar studentëve mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në programet e mobilitetit jashtë vendit. Gjithashtu kjo politikë është integruar me partneritete brenda dhe jashtë vendit, për të realizuar trajnime e kualifikime të ndryshme.



MP në Kontabilitet
MP në Financë
MP në Informatikë ekonomike
MP në Ekonomia dhe e drejta në sektorin publik

Master i shkencave në Manaxhim
Master i shkencave në Marketing
Master i shkencave në Drejtim bankar
Master i shkencave në Kontabilitet dhe auditim
Master i shkencave në Ekonomia dhe e drejta në tregjet ndërkombëtare
Master i shkencave në Informatikë Ekonomike

Nunuri i studentëve, që studiojnë në këtë fakultet aktualisht është 2718 studentë në të gjitha programet e studimit duke diplomuar çdo vit më shumë se 300 studentë dhe duke u renditur ndër preferencat kryesore të studentëve që dëshirojnë të studiojnë në FE. Që me diplomimin e brezit të parë të studentëve në vitin 1999, prej 22 vitesh kemi përgatitur disa breza specialistësh të fushës së ekonomisë fillimisht në përputhje me ciklin 4-vjeçar të studimeve e më pas me organizimin sipas Kartës së Bolonjës me programe bachelor shogëturar me mundësi ndjekje të programeve të ciklit të dytë, 3+1 ose 3+2 , master profesional dhe master i shkencave. Staf i akademik me kalimin e viteve është kualifikuar, ndërkohë dhe studentët kanë përfunduar nga eksperiencia e tyre në mësimdhënie si dhe nga eksperiencia e Profesorëve dhe specialistëve të fushës së ekonomisë të ftuar nga Universitete vendase dhe të huaja, duke siguruar cilësi në mësimdhënie dhe një përgatitje sa më të vlefshme për studentët, duke nxjerrë në tregun e punës specialistë të aftë të fushave të ndryshme të ekonomisë. Në asnjë rast nuk ka munguar përkushtimi dhe përgatitja e lartë profesionale e stafit të FE. Aktualisht FE ka mbi 90% të stafit të kualifikuar, ku mund të përmendim 12 antarë të personelit akademik të kategorisë Profesor, 29 Doktorë të shkencave dhe 4 doktorantë. Mësimdhënia mbulohet në më shumë se 70% të programeve të studimit nga personel akademik me kohë të plotë i FE dhe nga personel akademik me kohë të plotë nga departamente të tjera të UE për disa lëndë karakterizuese, si p.sh. matematika, gjuhë angleze, lëndë e specialitetit të informatikës, etj.


Nga bashkëpunimi me universitete dhe institucione të ndryshme vendase e të huaja, fakulteti ka përfunduar prej tyre një kontribut shumë të rëndësishëm ndër vite. Konsolidimi i programeve të studimit ka ardhur gjithmonë në rritje përmes përvojave pozitive dhe nëpërmjet kualifikimit të personelit tonë akademik, si dhe bashkëpunimit me Fakultetin Ekonomik të UT, UBT, etj. si dhe pedagogëve të ftuar nga universitete të huaja si p.sh. Nga Universitë degji Studi di Bari Aldo Moro (Itali), të cilët i kanë dhënë një tjetër dimension procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. Bashkëpunimi me Univeritetin e Barit, Itali, ka mundësuar krijimin e një periudkë multidisiplinor shkencor të përbashkët me titull: Euro-Balkan Law and Economics Review me E-ISSN: 2612-6583 dhe Kod ANCE: E251746(<https://ojs.cimedoc.uniba.it/index.php/law/about>).



mundësuar formimin kërkimor shkencor të tyre, duke i aftësuar për një karrierë të sukseshme si akademikë ashtu edhe profesionale jo akademike.

Sipas INSTAT (<http://www.instat.gov.al/media/8185/press-release-statistika-te-regjistrimeve-2020-21.pdf>), për vitin akademik 2020-2021, studentët duket se preferojnë fushën e studimit “Biznes, administrim dhe ligj”, ku është përqendruar një e katërta e numrit gjithsej të studentëve (Fig.1.).

Figura 1: Të diplomuar sipas fushave të studimit



Burimi: INSTAT (2021)

Kjo preference dallohet dhe në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ku studentët e regjistruar në programet e ciklit të dytë, Master i shkencave të FE, përbëjnë 29.2% të numrit të studentëve të regjistruar gjithsej në UE gjatë vitit akademik 2021-22³. Offrimi i një program të ciklit të tretë të studimeve, do të mundësonte përmirësimin e kurrikulës tonë universitare duke e kompletuar me të tre ciklet e studimit për fushat e kërkimit në shkencat ekonomike. Ky program do të mundësonte që studentët tanë të mos largohen jashtë Shqipërisë për të ndjekur këtë cikël studimesh dhe për t’u punësuar atje si dhe do të përmirësonte situatën e BRAIN DRAIN, duke u dhënë atyre një mundësi punësimi edhe brenda institucionit tonë.

Propozimi i këtij projekti është në përputhje dhe me vizionin e strategjisë kombëtare për arsim 2021-2026 të vendit tonë, për ofrimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe të bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.⁴ Në zbatim të kësaj strategjie, duke ofruar një program studimi të ciklit të tretë që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik dhe transparences, do t’i shërbejmë më mirë rritjes së cilësisë në arsimin e lartë

³ Statistika të UE-së, Drejtorja e Standardeve dhe Kurrikulave, 2021.

⁴ Strategjia kombëtare për arsimin 2021-2026



lidhen me zhvillimin e temës së miratuar të disertacionit. Doktorantët do të aftësohen të hartojnë një disertacion shkencor që jep një kontribut original në fushën e tyre të kërkimit dhe do të inkurajohen për të zhvilluar analiza të thelluara kritike e të argumentuara në tematikat përkatëse. Doktorantët do të kenë mundësi të krijojnë lidhje të ngushta midis këtyre programeve studimesh dhe institutëve apo enteve të tjera kërkimore publike dhe private, me qëllimin përfshirjen e tyre në fusha kërkimi në një kontekst më të gjerë ekonomik. Ky program do t'u ofrojë studentëve të doktoratës mundësinë e kërkimit shkencor nën supervisionin e udhëheqësit shkencor të kategorisë “Profesor”.

Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Elbasanit në mënyrë të vazhdueshme është angazhuar në shkrimin dhe finalizimin e projekteve, ndër të cilat mund të përmendim projektet më të fundit të të organizuara dhe finalizuara si në vijim:

- Në Universitetin e Elbasanit, “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti Ekonomik për të nëntritur radhazi, organizoi konferencën e 9-të ndërkombëtare me titull “Advances in Business, Finance and Law”, me 13.11.2021, me pjesëmarrje të gjerë nga studiues vendas dhe të huaj të fushës. Aktet e konferencës janë botuar në Proceedings book të konferencës.
- Me mbështetjen e Komisionit Europian në kuadër të programit Erasmus+, në datat 10-11.11.2020 u realizua në Vlorë konferenca përmblyëse e projektit TEAVET, një bashkëpunimim ndërmjet Universitetit të Vlorës, Universitetit të Elbasanit, Universitetit të Korçës, Universitetit të Sporteve, Universitetit të Durrësit, Universitetit të Gjirrokastresë, ASCAP, Universitetit të Leon, Spanjë, Universitetit të Turku, Finlandë dhe Universitetit të Krems, Austri. Në konferencë morën pjesë studiues vendas dhe të huaj të cilët prezantuan punimet e tyre në lidhje me kompetenca të reja të edukimit dhe arritjen e objektivave të integritimit në BE. Aktet e konferencës u publikuan në Proceedings book, me ISBN: 978-84-18490-10-1, nga Universiteti i Leonit, Spanjë,
- Në bashkëpunim me Komisionerin për mbrojtjen kundër diskriminimit u realizua konferenca e 8-të ndërkombëtare në FE, me titull: “Regional Economic Cooperation and Harmonization of Legislation, as the Premise for European Integration of Western Balkans Countries”, me 21.12.2019, finalizuar me publikimin e akteve të konferencës në proceedings book, ISBN 978-9928-321-04-6.
- Në bashkëpunim me Universitetin e Barit “Aldo Moro”, Itali është realizuar krijimi i një periodiku multidisiplinor shkencor të përbashkët me titull: Euro-Balkan Law and Economics Review me E-ISSN: 2612-6583 dhe Kod ANCE: E251746 (<https://ojs.cimedoc.uniba.it/index.php/law/about>).
- Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Magedonia e Veriut, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” dhe Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, organizuan për të tretin vit radhazi konferencën e tetë ndërkombëtare me titull “Scientific Challenges for Sustainable Development”, në Strugë, 19 Qershor 2021.
- Në kuadër të pjesëmarrjes në rrejtin KULTAX, triet bashkëpunimi mes Universiteteve të Europës Qëndrore, me fokus në përmirësimin e kërkimit shkencor si dhe në kuadër të programit CEEPUS, me 28.05.2021 u zhvillua konferencë online me titull “Finacial



E-VIVA - Enhancing and Validating service related competences in Versatile learning environments in Western Balkan Universities;

TEAVET - Developing teacher competencies for a comprehensive vet system in Albania;
ENTRAL - Entrepreneurial skills for a modern education in Albania, etj.

Ky projekt sjell si risi rrifjen e standardeve të kërkimit shkencor në fushën e ekonomisë në rajonin e Elbasanit e më gjerë, duke e promovuar Universitetin e Elbasanit si Lider Rajonal në Kërkim Shkencor. Gjithashtu do të rrisë kapacitetet kërkimore të stafit akademik me karakter mësimor dhe kërkimor si dhe specialistëve të fushës së ekonomisë dhe do të kontribuojë në plotësimin e Universitetit të Elbasanit me staf akademik me një nivel më të lartë kualifikimi shkencor, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkim. Implementimi i këtij projekti i shërben thellimit të njohurive të fushës së ekonomisë dhe rritjes së standardeve si në aspektin akademik, ashtu edhe në aspektin profesional jo akademik. Njëkohësisht do të shërbejë dhe si një mundësi më shumë që ne mund t'i ofrojmë studentëve tanë më të mirë të cilët duan të thellojnë studimet, për të zgjedhur universitetin tonë dhe për të mos u larguar jashtë Shqipërisë për mungesë mundësishe dhe ofertës akademike.

Projekti vjen si një vlerë e shtuar për të përballuar sfidat e kohës, duke e vlerësuar arsimin e lartë si përgjegjësi publike, duke e konsideruar universitetin si një institucion që mbështetet në dy shtylla me të njëjten peshë e rëndësi: mësimdhënia dhe kërkimi shkencor; për t'iu përgjigjur kërkesave të ligjit "Për Arsimin e lartë e kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", duke e konsideruar kërkimi shkencor si kriter i vlerësimit institucional, të rankimit dhe financimit.

METODOLOGJIA E PROJEKTT

Për propozimin e këtij projekti është grumbulluar dhe studiuar literaturë me qëllim analizën e kontekstit në të cilin lind nevoja për të hartuar këtë projekt-propozimi, arritjeve të deritanishme dhe krijimin e bazës teorike për hulumtimin të mëtejshëm. Pas kësaj është realizuar grumbullimi i të dhënave sekondare që disponojnë sistemet e ndryshme të informacionit të publikuara deri në momentin aktual (kryesisht publikime të INSTAT, MAS). Për të identifikur nevojat për këtë program studimi të propozuar në kuadër të këtij projekti është përdorur metoda e anketimit me alumni, studentët e Msc. stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, nëpërmjet së cilës janë marrë informacione rreth interesit dhe kërkesës për të vazhduar një program të studimeve të ciklit të tretë.

Metodologjia e realizimit të këtij projekti konsiston në organizimin e studimeve të doktoratës në fusha kërkimi, të cilat do të përmblajnë veprimtari kërkimore-shkencore me qëllim garantimin e formimit në fushën/nënfishën përkatëse të studimit.⁵

Kandidatët paragesin projekt propozimet e tyre, duke marrë në konsideratë fushën e përgjithshme të kërkimit, shkencat ekonomike, fushat specifike të kërkimit brenda fushë së përgjithshme si dhe strategjinë dhe prioritetet e zhvillimit të vendit. Në çdo rast, projekti i

⁵ VKM nr.185 datë 25.03.2021, pika 2/1.b.



10. Shpenzimet publike dhe llogaridhënia financiare në Shqipëri.

Gjithashtu, gjatë studimeve doktorale, studentët do t'i nënshtrohen trajnimeve mbi metodologjinë e kërkimit shkencor, çështjet etike, përgatitjen dhe shkrimin e një artikulli për botim në një revistë shkencore, përgatitjen e një prezantimi ose posteri në një aktivitet shkencor, të dhënave mbi bibliografinë dhe paraqitjen e saj, databasa, faktori i impaktit dhe përgatitja e grafikëve të nevojshme për zhvillimin e tezës doktorale.

ORGANIZIMI I STUDIMEVE TË DOKTORATËS

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtarië krijuese dhe viti doctoral, do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 ose 5 vjet, si në vijim:

Elementët e Planit Vjetor (Studimet e Doktoratës 3 vjeçare)							
Viti	Formimi Teorik Kërkimor Shkencor	Pjesëmarrje në Konferenca	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mesimdhënie lidhur me fushën e kërkimit	Shqyrtimi i literaturës	Zbatimi i projektit	Hartimi i planit të projektit të kërkimit, ku të përshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
I							
II	Përmirësimi/ndryshimi i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës		Aktivitet në institucione apo organizata biznesi sipas fokusit të kërkimit, në funksion të projektit shkencor.	Prezantimi i punimeve në departamenti	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit të komisionit, mbrojtja e tezës.
III	Shkrimi i disertacionit		Pjesëmarrje në aktivitete shkencore (konferenca, seminare) me interes në fushën e kërkimit				

Viti		Elementët e Planit Vjetor (Studimet e Doktoratës 5 vjeçare)			
I	Formimi Teorik Kërkimor Shkencor	Pjesëmarrje në Konferenca	Aktivitete specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Shqyrtimi i literaturës	Asistencë në mesimdhënie lidhur me fushën e kërkimit
I					
II	Përmirësimi/ndryshimi i planit të projektit		Aktivitet në institucione apo organizata biznesi sipas fokusit të kërkimit, në		Hartimi i planit të projektit të kërkimit, ku të përshihen të paktën qëllimi, metodat e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
					Publikime shkencore mbi EKSA dhe analiza statistikore



- programin e doktoratës si dhe t'i përgjigjet nismave apo iniciativave të secilit person potencial për të ndjekur programin. Përzgjedhja e kandidatëve lidhet me plotësimin e kriterëve për pranim, si dhe pikëzimin e dosjes së secilit aplikant. Pjesën më të rëndësishme të aplikimit e zë projekt propozimi i tezës doktorale.
- Faza e dytë, është faza e studimeve doktorale, e cila fillon me fitimin e statusit të doktorantit, ku studenti ndjek programin individual të studimeve, referuar projektit kërkimor shkencor të paraqitur nga ai. Gjatë kësaj kohe, doktoranti është i përfshirë në aktivitetet kërkimore shkencore të institucionit si dhe në aktivitetet kërkimore shkencore jashtë vendit.
- Faza e tretë, është e lidhur me promovimin dhe integrimin në marrëdhëniet e punës, të doktorantëve. Promovimi do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes si organizatorë të konferencave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga Fakulteti Ekonomik.

ANALIZA SWOT


Një faktor kryesor për suksesin të projektit të studimeve të doktoratës në "Shkencat Ekonomike" lidhet me maqjen e performancës dhe kapacitetit të Universitetit të Elbasanit për implementimin e tij. Analiza SWOT është një mjet për vlerësimin veçak institucional dhe përfshin analizën e katër komponentëve: Pikat e forta (Strengths), Dobësitë (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) , Kërcënimet (Threats). Referuar këtij projekti, analiza SWOT paraqitet si në vijim:

STRENGTHS Pikat e forta	WEAKNESSES Dobësitë	OPPORTUNITIES Mundësitë	THREATS Kërcënimet
-Ecuria shumë e mirë e programeve në ciklin e parë dhe të dytë të cilar kanë përmbajtje bashkëkohore, referuar modeleve më të përparuara ndërkombëtare, duke u konsideruar ndër programet më të preferuara nga studentët. -Tradita e mirë në përgatitjen e specialistëve të fushës së ekonomisë dhe specialistëve të së drejtës së aplikuar në ekonomi. -Reputation pozitiv në rajon në përgatitjen e këtyre	Numër relativisht i ulët i personelit akademik në kategorinë profesor çka ndikon dhe në përcaktimin e kuotave të programit të studimit të doktoratës.	-Kërkesat e larta për t'u regjistruar në këtë program studimi nga ALUMNI, staf i akademik me kohë të pjesshme dhe profesionistë të fushës.	Rënia e numrit të studentëve në ciklet e studimit për shkak se studentët zgjedhin të largohen jashtë vendit.




<p>-Lidhja e marrëveshjeve të ndryshme të bashkëpunimit me institucione, institutet kërkimore, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme si të gytetit të Elbasanit, ashtu dhe në rang vendi.</p> <p>-Frymë pozitive bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës dhe aktorë të tjerë shogërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë.</p>	<p>Tregu i punës është i pastabilizuar dhe ofron mundësi punësimi e financimi jo konkurruese. Pamjaftueshmëri e politikave aktive të tregut të punës për të rinjtë e sapodiplomuar.</p>	<p>Mundësi për të gërshtetur eksperiencën e studimeve në FE, me eksperiencë të përfihar nëpërmjet mobiliteve në Universitete të tjera të huaja partnere dhe për të sjellë risi në kërkim, nëpërmjet përfshirjes në programe të ndryshme në nivel ndërkombëtar.</p>	<p>Zgjidhja e afatit të studimit përtej parashikimit, duke krijuar pengesa për udhëheqjen e doktorantëve të rinj, sipas kapaciteteve të personelit të angazhuar cdo vit në udhëheqje.</p>
<p>-Njësia kryesore është e gendrueshme me personel akademik dhe ndihmës akademik, i cili ka kualifikimin e duhur.</p> <p>-Njësia adreson në kohë të gjitha problemet e studentëve dhe të gjitha kërkesat e tyre marrin zgjidhje shpejt.</p> <p>-Dekani i FE kujdeset që studentët të informohen në lidhje me programin e studimit, kohëzgjatjen dhe të gjitha çështjet e mbarëvajtjes së studimeve.</p>		<p>Asistencë në aplikime në projekte të ndryshme si p.sh. JEAN MONNET, COST ACTION, etj. në funksion të tematikave krye të zhvillimit ekonomik Bashkimin European.</p>	<p>Braktisje e studimeve për arsye personale të studentëve.</p>
<p>-Njësia kryesore ofron një fond të pasur librash si dhe abonimin në një nga bibliotekat më të mëdha digitale JSTORE, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me AADF.</p>	<p>Fonde të kufizuara për kërkim shkencor dedikuar programeve doktorale (financuar nga vetë IAL-te apo projektet e lidhura me partnerët europianë)</p>		<p>Pamundësi për të përfunduar ciklin e studimeve për shkak të angazhimit jo të plotë të studentëve apo për shkak të kapacitit kërkimor pamjaftueshëm të studentëve.</p>
<p>-Garantimi i sigurimit të cilësisë, duke patur një politikë të qartë dhe një procedurë sistematike të vlerësimit për sigurimin e cilësisë së brendshme të programeve së FE ofron.</p>	<p>Vështirësi lidhur me mundësinë e krijimit të një network-u për studime post-doktorale, me qëllim angazhimit në vazhdueshëm kërkim të këtyre kapaciteteve humane.</p>		<p>Pamundësi financimi për shkak të papunësisë të studentëve rezultate të larta të cilët dëshirojnë të regjistrohen doktoratë.</p>





Burimi: INSTAT, 2021


Figurat 3: Studentët në arsimin publik (nr)



Burimi: INSTAT, 2021

Figurat 4: Studentët në arsimin privat (nr)





Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2021

Sic e dëshmojnë edhe të dhënat e Tabelës 2, pjesa me e madhe e studentëve, konkretisht rreth 62.4% (ose 60.791) rezultojnë të regjistruar në programet e studimit Bachelor. Vihet re gjithashtu se femrat përbëjnë rreth 61% të studentëve të regjistruar që ndjekin programet e studimit Bachelor në vitin akademik 2020-2021. Më pas, vijojnë regjistrimet në programet e cikleve të dyta të studimit Master Profesional dhe Master i Shkencave me 31%, ku sërish janë studentet femra ato që kanë peshën kryesore me rreth 69%. Po i njëjti trend ruhet edhe sa i përket studentëve të regjistruar në ciklet e treta të studimeve, ato doktorale me 1.9%. Këtu studentet femrat përbëjnë rreth 61.4%.

Të dhënat makro konfirmojnë se kemi mundësi të mira për zhvillim karriere në programin doktoral në shkenca ekonomike që propozojmë bazuar fillimisht në studentët që përfundojnë studimet në programet e studimit Master i Shkencave. Kjo duke marrë parasysh se deri tani vetëm Universiteti i Tiranës, ai Politeknik, Bujqësori i Mjekësisë, i Vlorës dhe Durrësit kanë ende studentë të regjistruar në studimet e doktoratës.

Tabela 2: Numri i studentëve të regjistruar në Universitetet Publike sipas programit të studimit 2020-2021

Universiteti	Total	
	Gjithsej	Femra
Studentë gjithsej	97,380	60,922
nga këta ndjekin Programin:		
Bachelor	60,791	37,063
1. Universiteti Tiranës	16,378	12,851
2. Universiteti i Mjekësisë	1,798	1,831



2.Universiteti i Mjekësisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.Universiteti Politeknik	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4.Universiteti Bujqësor i Tiranës	202	0	87	0	0	0	0	0	0
5.Universiteti i Arteve Tiranë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6.Universiteti i Sporteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7.Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	829	472	195	0	0	0	0	0	0
8.Universiteti "Fan S.Noli" Korçë	472	195	0	0	0	0	0	0	0
9.Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	39	17	0	0	0	0	0	0	0
10.Universiteti "Eqren Çabej" Gjirokastrë	339	172	0	0	0	0	0	0	0
11.Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12.Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	2.516	830	0	0	0	0	0	0	0
13.Akademia e Sigurisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14.Akademia e Forcave të Armatosura	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2021

Preferencat e studimeve

Studentët ndër preferencat e tyre të para kanë studimet në profilin ekonomik (përfshirë këtu programet e studimit të ciklit të parë e të dytë), edhe pse të dhënat kanë një trend rënës referuar 5-vjeçarit të fundit. Kjo situatë jep sinjale positive mbi premisa afatgjata sa i përket kërkesave të studentëve për programe doktorale në shkencë ekonomike (Tabela 3).

Tabela 3: Numri i studentëve në vite (programe të ndryshme studimi) sipas fushës së studimit

Viti shkollor / akademik	2015-16	2016-17	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21
Fushat e studimit						
Shkencë arsimit	11,236	11,779	10,689	10,062	9,062	8,367
Arte dhe shkencë humane	17,095	17,278	15,441	14,348	12,537	10,972
Shkencë sociale, gazetari dhe informacion	13,073	10,004	12,259	14,086	11,397	10,277
Biznes, administrim dhe ligj	41,523	36,471	30,233	33,447	32,732	31,173
Shkencë natyrore, matematikë dhe statistikë	6,719	7,816	6,325	7,060	5,962	4,924
Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	8,260	7,487	8,228	10,016	8,883	8,341
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	18,005	18,480	18,730	20,019	20,775	20,537
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	8,383	7,086	4,564	4,999	4,158	3,458
Shëndet dhe mirëqenie	21,550	20,900	19,837	20,727	20,199	21,195
Shërbime	2,433	2,306	3,088	4,279	4,559	4,553
Fushë e panjohur	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	148,277	141,410	131,833	139,043	130,264	123,797

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, 2021

Të diplomuar në Fakultetin Ekonomik të UE



8.Financë - Kontabilitet	71	99	38	154	77	46	57
---------------------------------	----	----	----	-----	----	----	----

Burimi: Drejtoria e Standartave dhe Kurikulave, UE, 2021

Studentë Ekselentë

Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" në ciklin e parë të studimeve "Bachelor" sa i takon vitit akademik 2020-21 numri i studentëve me rezultate të shkëlqyera është 3 (tre). Këta studentë janë bërë pjesë e projekteve ERASMUS+ në kuadër të mobiliteteve por dhe janë angazhuar në konferenca shkencore si dhe në projekte të tjera me në focus kërkimin shkencor. Në nivel Universiteti ka një numër të konsiderueshëm studentësh me notë mesatare mbi 9, janë mbi 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) studentë për ciklin e parë dhe për ciklin e dytë të studimeve sipas tabelës në vijim (Tabela 5):

Tabela 6: Studentë Ekselentë

Nr.	Fakulteti	Numri i studentëve
1	FSHN	12
2	FSHH	29
3	FSHE	37
4	FE	57
5	FSHMT	22

Burimi: Drejtoria e Standartave dhe Kurikulave, UE, 2021

Përsa më lart, konfirmohet se Fakulteti Ekonomik është gjithashtu lider në këtë aspekt, çka na angazhon maksimalisht të avancojmë me ofertën tonë akademike.

Personeli Akademik me Kohë të Pjesshme

Për vetë numrin e programeve që ofron Fakulteti Ekonomik është gjithashtu lider në punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme krahasuar kjo me fakultetet e tjera të Universitetit "Aleksandër Xhuvani". Ndër të tjera, vlen të përmendet fakti se rreth 85-90% të burimeve njëzore që përfitojnë kontratat e punësimit me kohë të pjesshme janë ish-studentë të Fakultetit Ekonomik. Vitet e fundit i është dhënë prioritet edhe prurjeve nga Universitete të tjera në vend. Ballkan e Europë. Kjo jo vetëm për të zgjeruar networkun akademik por edhe ka përmirësuar ndjeshëm ofertën didaktike. Nevoja e një kualifikimi të mëtejshëm nga ana e personelit akademik, është bërë një faktor nxitës lidhur me ofrimin e programit të ciklit të tretë të studimeve.

Tabela 7 : Personel akademik me kohë të pjesshme angazhuar në Fakultetin Ekonomik për v.a 20-21



Bashkia Belsh	8	1	3
Bashkia Elbasan	44	1	5
Bashkia Librazhd	11	0	2
Bashkia Prrerijas	6	2	2
Bashkia Cërrtik	6	0	1
Bashkia Gramsh	9	0	3
Bashkia Pegin	1	0	4
Bashkia Rrogozhinë	1	0	1
Bashkia Divjake	0	2	0
Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shogërore Elbasan	39	2	1
Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan	15	0	0
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	11	1	17
Drejtoria Shëndetësore Elbasan	1	1	0
Drejtoria e Shëndetit Publik Gramsh	1	0	0
Drejtoria Shëndetësore Pogradec	1	0	0
FSDKSH Elbasan	6	3	0
Drejtoria Shërbimiti Spitalor Librazhd	1	0	0
Drejtoria e Shëndetit Publik Librazhd	1	0	0
Dega Doganore Elbasan	6	0	3
DRSHTRR Elbasan	11	0	0
Keshilli i Qarkut Elbasan	3	0	3
IEVP Pegin	3	0	0
IKMT Elbasan	3	0	2
OSSH Elbasan	15	0	11
Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"	19	1	9
Prefekti i Qarkut Elbasan	7	0	2
Posta Shqiptare Elbasan	40	1	0
Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan	7	0	0
Qendra Spitalore "Xhaferri Kongoli" Elbasan	20	0	0
Spitali Psikiatrik "Sadik Dinqi" Elbasan	3	0	0
Zyra Vendore Arsimore Berat	1	0	0
Zyra Vendore Arsimore Librazhd	2	0	0
Zyra Vendore Arsimore Pegin	3	0	0
Zyra Vendore Arsimore Tiranë	1	0	0

Bartini: Drejtoria Juridike. Këshillimni të Kariervës dhe Humni va 20-21, UE

Institucionet si më lart, në cilësinë e operatorëve kryesorë në tregun e punës rajonal e jo vetëm vlerësojnë si çështje me interes të lartë edukimin e punonjësve si dhe kualifikimin e tyre të vazhdueshëm. Ndaj dhe prioriteti i Fakultetit Ekonomik është të përshlasë me nevojat e tregut kurrikulat e programeve të studimit si dhe të formatojë këtë të fundit kundrejt nrive në tregje.



Tabela 11 : Bilanci i forcave të punës, 2016-2020 (në mijë)

Emërtimi	2016	2017	2018	2019	2020
Forca e punës	1,163	1,185	1,213	1,218	1,214
<i>Meshkuj</i>	608	621	638	635	627
<i>Femra</i>	555	564	575	583	587
Të punësuar	1,043	1,096	1,138	1,147	1,131
<i>Meshkuj</i>	548	579	602	601	588
<i>Femra</i>	495	517	536	546	543
Punëkërkes të papunë të regjistruar	120	89	75	71	83
<i>Meshkuj</i>	60	42	36	34	39
<i>Femra</i>	60	47	39	37	44

Burimi: Të dhëna administrative, INSTAT, 2021

Trendi i punësimit rinor dhe segmentimi i tregut

Sipas studimeve tregu i punës në Shqipëri është cilësuar si mjaft specifik dhe i pakrahueshëm me asnjë treg të tjetër lloji në vendet e zhvilluara industriale të Europës dhe ndahet në tre pjesë kryesore referuar shifrave të Institutit të Statistikave (INSTAT, 2020). Të dhënat tregojnë për një administratë publike me rreth 164 mijë individë të punësuar (ose 17.7%); kompanitë private të regjistruara në sektorin industrial të cilat ofrojnë rreth 320 mijë vende pune (ose 34.4%); sektori i bujqësisë, për të cilin të dhënat zyrtare tregojnë për më shumë se 440 mijë individë (pjesa e mbetur 47.9%).

Nga ana tjetër, na duhet të pranojmë se Shqipëria me rreth 3 milion banorë, me një fuqi punëtore (15-64 vjeç) që përbën më shumë se 68% të popullsisë.

Struktura prodhuese në Shqipëri mund të ndahet në tre pjesë gati të barabarta të ndërmarrjeve të regjistruara si më poshtë:

-ndërmarrjet me 1-4 të punësuar që angazhojnë 34,5% të fuqisë aktive (dhe realizojnë 15,9% të shifreve neto);

-ndërmarrjet me 80+ punonjës që përbëjnë 31,5% të totalit, (dhe realizojnë 38,6% të shifreve neto dhe investojnë 53,9% në investime totale);

-ndërmarrjet me 5-79 punonjës që punësojnë 34% të totalit të fuqisë punëtore.

Nga të dhënat e mësipërme vërehet që struktura prodhuese në Shqipëri dominohet nga mikro-njësitë me 1-4 të punësuar, që funksionojnë kryesisht në bazë të lidhjeve familjare dhe që veprojnë në masën dominuese në Tregunë me Pakicë, Industrinë Përpunuese dhe Hotelieri.

Një segment shumë i rëndësishëm në përcaktimin e kërkesës për kualifikime veçanërisht në zonat urbane, ndodhet në zonën metropolitane qendrore Elbasan - Tiranë apo Durrës - Tiranë, ku gjendet pjesa më e madhe e kompanive që punësojnë 80+ dhe sigurojnë pjesën më të madhe të kërkesës për punësim. Referuar fuqisë punëtore, të bazuar në anketën e përqendrimit të INSTAT,



1	Prof.as.Dr.	Imelda Seidini	Personel Akademik (Kordinator)
2	Prof.Dr	Ali Turhani	Personel Akademik
3	Prof.as.Dr.	Gjergji Shqau	Personel Akademik
4	Prof.as.Dr.	Nada Tapija	Personel Akademik
5	Prof.as.Dr.	Alketa Vangjeli	Personel Akademik
6	Prof.as.Dr.	Shpetim Çerri	Personel Akademik
7	Prof.as.Dr.	Elvira Fetahu	Personel Akademik
8	Prof.as.Dr.	Altin Idrizi	Personel Akademik
9	Prof.as.Dr.	Marsida Ashiku	Personel Akademik
10	Prof.as.Dr.	Rezarta Tahiraj	Personel Akademik
11	Prof.as.Dr.	Arber Gjeta	Personel Akademik
12	Prof.as.Dr.	Agim Anxhaku	Personel Akademik
13	PhD	Ardita Todri	Personel Akademik
14	Dr.	Jonida Bicoku	Personel Akademik
15	Dr.	Albana Madhi	Personel Akademik
16	Dr.	Artan Spahiu	Personel Akademik
17	Msc.	Diamanta Vito	Personel Akademik
18	Msc.	Orgen Bardhi	Personel Ndihmës akademik (Laborant)
19	Msc.	Ergjola Piligrju	Personel Ndihmës akademik (Sekretare)
20	Msc.	Juliana Bajraktari	Personel ndihmës akademik (Specialist protokoll arkiv)

FINANCIMI I PROJEKTTI

Kjo pjesë e studimit i referohet pikë së pari doktorantëve që priet të regjistrohen në programin e studimit Doktoratë në Shkencat Ekonomike sipas kuotave të parashikuara. Periudha e marrë në shqyrtim është viti 2022 deri në vitin 2024 e ndarë sipas viteve akademike.

Tabela 13: Përmbledhëse e parashikimit të nr. të doktorantëve për periudhën 2022-2024

Përshkrimi	Shtator 2022	Shtator 2023	Shtator 2024
Numri i studentëve aplikantë për ciklin e tretë të studimeve	49	39	29
Kuotat për ciklin e tretë të studimeve	10	10	10

Burrini: Planifikimi i kuotave doktorale sipas programit të propozuar, 2021

Të dhënat janë analizuar kundrejt kërkesave aktuale të grumbulluara ndër vite nga personeli akademik me kohë të pjesëshme angazhuar në Fakultetin Ekonomik dhe në tabelën e mësipërme janë paraqitur shifrat e pritshme për periudhën 2022-2024 përsa i takon kuotave vjetore të propozuara.

Fakulteti ekonomik ushtron veprimtarinë kërkimore shkencore dhe akademike në mjediset e godinës së tij. Përllogaritja e sipërfaqeve mjedisore funksionale për një student është llogaritur me sipërfaqet dhe numrin e studentëve të këtij fakulteti për vitin akademik 2020-2021.



akademikë me titull Profesor, pagën mesatare të punonjësve ndihmës mësimorë; 11 % e shpenzimeve operative dhe 23 % e investimeve në buxhetin e parashikuar të vitit 2021, është llogaritur kosto e përgjithshme e studimeve për një doktorant në FE dhe parashikohet në vlerën 4,502,957 lekë ose 450,296lekë/Vit.

Nr	Shpenzime	Lek/doktorant/vit
1	Shpenzime per pagat e sigurimeshoqerore	352,014
-	Paga / Prof & Prof.As	289,064
-	Pagapers/ndlime	12,576
-	Sigurimeshoqerore	50,374
2	Shpenzimetjera	98,282
-	Përsërbime	31,797
-	Per investime	66,485
	Shumashpenzimeve	450,296

Të dhënat e mësipërme janë referuar pagës mesatare të punonjësve akademikë në fakultet, shpenzimeve të planifikuara në buxhetin e vitit 2021 dhe koeficientëve në bazë të studimeve të kryera nga MASR për numrin mesatar të studentëve doktorant për një grup mesimor, ndërkohë që numri i punonjësve mësimorë për një student doktorant është 1.92 punonjës. Universitet publikë financohen kryesisht me bashkëfinancim: Grant nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat e Universitetit, ndërkohë që sipas kostos së përgjithshme të studimeve për programin e studimit “Doktoratë në shkencat ekonomike”tarifat e shkollimit është parashikuar të përballohet 100% nga të ardhurat e krijuara nga pagesa e tarifës vjetore të studentëve doktorant dhe 0 % nga granti i Buxhetit të Shtetit duke llogaritur kuotën prej 10 studentë me tarifën eparashikuar 450.000 lekëose 150,000 lekë në vit akademik.

KOORDINATORI

Prof.as.Dr. Imelda Sejdimi

